
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrative të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës, 05nr.350/02 - 81861/21 dt.11.05.2021, të Ministria e Shëndetësisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për caktimin e kushteve ndërtimore, për ndërtimin e "Depo qendrore e vaksinave COVID 19", me etazhitet P+0, në kuadër të Kompleksit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovë – QKUK-së, pjesës së Parcelës ndërtimore "A1/1-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë të rregullt administrative me datë 16.06.2021, merr:

V E N D I M
CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore, kërkuesit, Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas kërkesës 05nr.350/02 -81861/21 dt.11.05.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e "Depo qendrore e vaksinave COVID 19", me etazhitet P+0 - në Kompleksin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – QKUK-së, pjesës së Parcelës ndërtimore "A1/1-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht pjesës së parcelës kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë (në pjesët e parcelave nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë, sipas KGP-së), sipas projekt propozimit konceptual - Plani i situacionit / "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

II. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të pjesës së Parcelës ndërtimore "A1/1-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01 nr.35 - 186850 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar "QKS";

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelës kadastrale, nr.2805-9 ZK Prishtina, sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr.2805-9.....S=363,789m²....."QKS-së"....."Tokë ndërtimore";
- E drejta pronësore - juridike e parcelës kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë, është P.SH. në bazë certifikatës së njësisë dhe evidencës kadastrale;
- Në kuadër të pjesës së parcelës kadastrale nr.2805-9 ZK Prishtinë (pjesëve nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë, sipas KGP-së), përfshihen depot e "QKUK-së", me etazhitet P+0 dhe ndërtesa afariste me etazhitet P+1;
- Terreni është kryesisht i rrafshët;
- Qasja ekzistues e parcelës kadastrale nr.2805-9 ZK Prishtinë (pjesëve të parcelave nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë) është përmes rrugëve të Kompleksit të "QKUK-së";
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m` ka ndërtesa ekzistuese në shërbim të "QKUK-së";

COVID 19"- në kuadër të QKUK-së – Qendrës Spitalore, konkretisht pjesës së Parcelës ndërtimore "A1/1-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", gjegjësisht pjesës së parcelës kadastrale nr.2805-9 ZK Prishtinë (në pjesët nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë, KGP-së), bazuar në parametrat dhe kriteret urbane, janë:

- Organizimi & qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesës, raporti i ndërtesës me vijën rregulluese & ndërtimore, distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane" bashkangjitura vendimit të kushteve ndërtimore;
- Parcela kadastrale për realizimin e "Depo qendrore e vaksinave COVID 19", me etazhitet P+0, e trajtuar brenda parcelës ndërtimore "A1/1-1", është:
 - nr.2805-9 ZK Prishtinë (në pjesët nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë), me $S \sim 2300 \text{ m}^2$;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të pjesës së Parcelës ndërtimore "A1/1-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", gjegjësisht pjesës së parcelës kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë (në pjesët nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë) planifikohet të ndërtohet "Depo qendrore e vaksinave COVID 19", me etazhitet P+0, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

"Depo qendrore e vaksinave COVID 19",

Depo - $S=938.00 \text{ m}^2 / 938.00 \text{ m}^2$, mbi tokë + 0.00 m^2 , nën tokë /,

Etazhitet: P+0,

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë për deponimin e vaksinave të COVID 19 dhe materialit tjetër të nevojshëm të "SHSKUK-së", si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, zyre e laborantit, hapësira e ngarkesës, dhoma e ftohët dhe ajo e thatë (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti i ndërtesës është P+0 (përdhese e lartë $H=6.40 \text{ m}'$);
- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore / pjesës së parcelave kadastrale të bashkuara në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdheseve ose suterrenit, lejohet max.40%, dhe kjo sipërfaqe është:
 $S=3447 \times 0.4=1378.80 \text{ m}^2$ / sipas planit rregullues /,
 $S=938.00 \text{ m}^2$ /sipas projekt propozimit/.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN),për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe kjo sipërfaqe është:
 $S=3447 \times 0.6=2068.20 \text{ m}^2$ / sipas vendimit të kryetarit /,
 $S=0.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe hapësira me sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) min. 40%, bazuar në Vendimin 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës me gjelbërim të lartë & të ultë, dhe të organizuara për sport & rekreacion. Sipërfaqet gjelbëruese, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, për kompleksin është:
 $S=3447 \times 0.4=1378.80 \text{ m}^2$ / sipas planit rregullues /,
 $S=1380.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit/
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" për Parcelën ndërtimore "A1/1-1" nuk përcaktohet, kurse trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe, sipas projekt propozimit është $S=938.00 \text{ m}^2$;

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë $1.0 \times H$ (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje $0.5 \times H$ ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj);
- Etazhiteti për Parcelën ndërtimore "A1/1-1", nuk përcaktohet;
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max. 30cm;
- Qasjet në kompleks të jenë nga rrugët e planifikuar të planit rregullues urban, sipas planit të situacionit / zgjidhjes urbane;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret, këndet e lojërave për fëmijë, terrenet sportive, mobiliari urban, etj.;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuara në kriteret & parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë.

V. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- *Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;*
- *Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;*
- *Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;*
- *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në orto-foto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*
- *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).*

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*
- *Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;*
- *Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;*

relative dhe absolute;

- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

VII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

VIII. Nga pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi kërkuesi - Ministria e Shëndetësisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lirohet bazuar në nenin 14 të "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017.

IX. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuesi / Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesën 05nr.350/02 -81861/21 dt.11.05.2021, ka kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore

për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e "Depo qendrore e vaksinave COVID 19", me etazhitet P+0, në lokacionin e përkthyer në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën 05nr.350/03 -147909/19 dt.27.06.2019, për kushte ndërtimore, dhe plotësuar me shkresë "Kërkesë për kushte ndërtimore" 05nr.350/02 – 107679/21 dt.11.06.2021, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dokumentacioni dhe provat si në vijim:

- Dëshmia mbi pronësinë: Certifikata e njësisë kadastrale për parcelën nr. 2805-9 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;
- Projekt propozimi konceptual për "Depo qendrore e vaksinave COVID 19", me etazhitet P+0, është hartuar nga "GM Architecture" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë ARBK 810061466, dhe me projektues Arben Meha;
- Shkresa "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02- 81861/21 dt.11.05.2021, e lëshuar nga kjo drejtori;
- Shkresa "Kërkesë", me numër protokollit 04166 dt.28.04.2021 të IKSHPK-së;
- Situacioni i terrenit për parcelat kadastrale, punuar nga Kompania gjeodezike "GeoHorizont"sh.p.k. nga Prishtina me licencë nr.54;
- Fotot e lokacionit.

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 -81861/21 dt.11.05.2021, dhe plotësuar me shkresën "Kërkesë për kushte ndërtimore" 05nr.350/02 – 107679/21 dt.11.06.2021, dokumentacionit të bashkangjitur, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, dokumentit të planifikimit hapësinor – Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, në mënyrë kronologjike dhe procedurale, konstaton se:

Kërkuesi i lartcekur, me kërkesën 05nr.350/02-81861/21 dt.11.05.2021, nuk ka bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm për caktimin e kushteve ndërtimore, andaj kjo drejtori, me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02 – 81861/21 dt.11.05.2021, ka kërkuar që dokumentacioni i prezantuar të plotësohet me dokumentacionin e nevojshëm, të cilën kërkuesi e ka plotësuar dhe dorëzuar me shkresën "Kërkesë për kushte ndërtimore" 05nr.350/02 – 107679/21 dt.11.06.2021, duke prezantuar edhe dokumentacionin shtesë për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo drejtori pas kompletimit të dosjes së lëndës me dokumentacionin e nevojshëm dhe me projekt propozimin konceptual të prezantuar, ka konstatuar se, parcela kadastrale nr.2805-9 ZK Prishtinë (në pjesët nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë), përfshihet në kuadër të Parcelës ndërtimore "A1/1-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", konkretisht në kuadër të Kompleksit të QKUK-së dhe se kjo zonë është e destinuar për nevojat të këtij kompleksi, andaj edhe kërkesën e ka trajtuar me prioritet duke pas parasysh edhe pandeminë globale të "Covid 19", dhe destinimin e ndërtesës "Depo qendrore e vaksinave COVID 19".

Bazuar në analizën e planit të situacionit të prezantuar, në raport me parcelat kadastrale, konkretisht parcelën nr.2805-9 ZK Prishtinë, konstatohet se ndërtesa shtrihet dhe i tangjenton parcelat kadastrale-pjesët e parcelave nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë (sipas GKP-së), gjithashtu me pronar/posedues P.SH., të cilat parcela (nr.2805-9 ZK Prishtinë), në mungesë të shënimeve kadastrale, nuk janë të harmonizuara me vektorët kadastral.

Bazuar në specifikat e kompleksit (Kompleksi i QKUK) dhe pikës 2 të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se nuk është e nevojshme vendosja e afishes "Njoftimi publik", andaj edhe ka vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Andaj si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", dhe në bazë të nenit 21 & 44 të LPPA-së Nr.05/L - 031 dt.21.07.2016, lidhur me ligjshmërinë për caktimin e kushteve ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit vendosi që ta miratojë kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e "Depo

e Re – Zona Perëndim” në Prishtinë, gjegjësisht pjesës së parcelës kadastrale nr.2805-9 ZK Prishtinë (në pjesët e parcelave nr.2802-0, 2804-0 dhe 2803-0 ZK Prishtinë, sipas KGP-së), sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - "zgjidhjes urbane" dhe projekt propozimit konceptual të prezantuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidha urbane" e "Depo qendrore e vaksinave COVID 19" me etazhitet P+0, në kuadër të "Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – QKUK-së".

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me vendimin e kushteve ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

I dërgohet: Kërkuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 81861/21 dt.11.05.2021.


I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02 – 81861/21 DT. 16.06.2021**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini,



U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori:
Ardian Olluri.



REPUBLIKA E KOSOVES
PRISTINE

Participation in the development of the
 Parcel 2804-0, Area 2074.4m²
 Parcel 2802-0, Area 1303.5m²
 Parcel 2803-0, Area 64.3m²
Total Area 3,447.2m²

Building Area 938m²
 ISH = 938 / 3467m²=0.27%
 IGJ = 1,301.55 / 3467m² =0.37%

Rev	Date	Description	Approved

Project Name: **Central Vaccine Storage UHCK Prishtinë**

Client: **Government of Kosovo Ministry of Health**

Implemented by: **UNOPS**

Design: **GM** (Logo)
SMART ARCHITECTURE Prishtinë
design and consultancy

Scale: P=1:200
 Drawing No: 2
 Work area: Prishtinë

Checked by: a.m.
 Date: Jun 2021

Series No: ARCH
 Rev:

